



ETAPAT E BESIMIT HYJNOR



RIPËRTËRITJA E IMANIT



GJUHA ARABE: BESIM,
MENDIM DHE QYTETËRIM

UDHA ISLAME

Viti 23 - Nr. 12 (274), Dhjetor, 2025

www.myftinia-shkoder.org

Botim i Myftinisë Shkodër
E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative



MYFTINIA SHKODER1990

HAPET UNIVERSITETI NDËRKOMBËTAR ISLAM I SHKENCËS DHE I TEKNOLOGJISË NË STAMBOLL

XHAMIA BLU "SULTAN AHMED", STAMBOLL

KMSH VLERËSON KONTRIBUTIN
E IMAMIT TË NDERUAR,
H. FEJZI ZAGANJORI

MYFTIU PRITI FORTLUMTURINË E TIJ,
KRYEPESHKOPIN JOAN

MYFTIU I SHKODRËS
VIZITOI BASHKËSINË ISLAME
NË LUGINËN E PRESHEVËS

MYFTINIA SHKODËR
URON BESIMTARËT ME RASTIN
E FILLIMIT TË TRE MUAJVE TË MIRË 1447 H

EKSPOZITA "NGJYRAT E BESIMIT"
NË QENDRËN KULTURORE BARBULLUSH

"GJUHA ARABE: BESIM, MENDIM DHE
QYTETËRIM", AKTIVITET ME RASTIN
E DITËS BOTËRORE TË GJUHËS ARABE

KMSH VLERËSON KONTRIBUTIN E IMAMIT TË NDERUAR, H. FEJZI ZAGANJORI



Ditën e mërkurë, më 3 dhjetor 2025, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari i shoqëruar nga një pjesë e stafit të tij, zhvilloi një vizitë në shtëpinë e imamit të nderuar, rahmetliut H. Fejzi Zaganjori.

Shkak i kësaj vizite ishte nderimi që Komuniteti Mysliman i Shqipërisë i bëri ditëve të fundit kontributeve të vyera imamit të xhamisë së lagjes Rus, H. Fejzi Zaganjori, pas vdekjes.

Gjatë këtij takimi Myftiu i Shkodrës falënderoi mikpritjen e familjarëve të H. Fejzi Zaganjorit, si dhe u lut bashkërisht me të pranishmit për shpirtin e tij duke theksuar se kontributet e tij përgjatë dekadave të rimëkëmbjes së aktivitetit të Myftinisë Shkodër kanë qenë të shumta dhe në fusha të ndryshme.

Ai theksoi se gjurmët e H. Fejzi Zaganjorit janë të shumta, jo vetëm në qytetin e Shkodrës, por në mbarë zonën e veriut dhe përtej, ku nëpërmjet angazhimeve të ndryshme që janë

kërkuar prej zotërisë së tij nga Myftinia Shkodër, por edhe nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, ai ka qenë gjithmonë i gatshëm për të shërbyer ku ishte nevoja.

Myftiu i Shkodrës i ka dorëzuar familjarëve të rahmetliut edhe nderimin që Komuniteti Mysliman i Shqipërisë i ka bërë angazhimeve dhe shërbimeve të tij pas vdekjes. Myftiu lexoi Certifikatën e Vlerësimit nënshkruar nga Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu.

Në përmbajtjen e këtij vlerësimi ndër të tjera theksohet: “Në shenjë mirënjohjeje për kontributin e çmuar të dhënë në shërbim të fesë dhe komunitetit, si imam i përkushtuar i xhamisë së Rusit në Myftininë e Shkodrës, si dhe për përkushtimin e treguar gjatë gjithë jetës si veprimtar i devotshëm i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, në ruajtjen dhe forcimin e harmonisë ndërfetare dhe vlerave shpirtërore.”



HAXHI FEJZI ZAGANJORI
(1945 - 2021)

Që me rifillimin e riorganizimit të Myftinisë Shkodër, pas vitit 1990, ka marrë pjesë në organizimin e aktivitetit fetar, kulturor e social, sidomos ato që lidhen me ndërtimin e xhamive të reja në qytet e fshat, si dhe me punën organizuese të përrimeve.

Gjatë një periudhe të gjatë ka mbajtur vaze (ligjëratë) në shumë xhamia, si në ditë xhumaje dhe për ceremoniale të ndryshme, si në: Bushat, Mjedë, Melgushë, Shkpezë, Mes-Myselim, Kullaj, Drisht, Ura e Shtrenjtë, Grudë-Fushë, Jubicë, Laçaj, Shirq, Shirokë, Kiras, “Ebu Bekër”, xhamia e Plumbit, Ganjollë, Kosmaç, Teqen e Rufaive në Shkodër, Berat dhe Krujë.

Poashtu ka ligjëruar në xhamitë e Beratit, Prizrenit, Ulqinit, Sarandës, Peshkopisë, Pukës, Kavajës, Vlorës, Lezhës, Krujës e në mënyrë të veçantë në xhaminë e Rusit.

Prej vitit 1996 dhe deri në vitin 2021 ka shërbyer si imam, hatib dhe mësues besimi në xhaminë e Rusit.



MYFTIU PRITI FORTLUMTURINË E TIJ, KRYEPESHKOPIN JOAN



Paraditen e së dielës, më 21 dhjetor 2025, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari priti në një takim kortezie, Fortlumturinë e Tij, Kryepeshkopin Joan, kreu i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë.

Gjatë takimit të përzemërt, Myftiu i Shkodrës shprehu kënaqësinë e tij për këtë vizitë të parë të F.T. Joanit në qytetin e Shkodrës, ku theksoi se, mozaikut të bukur të bashkëjetesës dhe harmonisë ndërfetare i shtohet sot edhe ky gur i çmuar, nëpërmjet kësaj vizite domethënëse.

Nga ana e Tij, Kryepeshkopi Joan u shpreh i gëzuar për këtë vizitë në Myftininë e Shkodrës dhe vlerësoi mikpritjen e Myftiut Sytari, ku vlerësoi qëndrimet e Myftinisë Shkodër dhe të Myftiut të saj në shumë çështje të përbashkëta dhe me interes për shoqërinë, si çështja e pronave të zaptuara, ajo e familjes, etj.

Gjatë bashkëbisedimit të përzemërt,

Myftiu i Shkodrës dhe Kryepeshkopi Joan vunë theksin te rëndësia që ka sot ruajtja e vlerave të familjes, e tabanit kombëtar, sikurse u theksua se komunitetet fetare me punën e tyre janë pjesë e pandarë e garantimit të sigurisë kombëtare, për ç’ka ata duhen vlerësuar më shumë dhe duhet marrë në konsideratë roli i tyre i padiskutueshëm në shoqëri, në ruajtjen e ekuilibrave, në mbrojtjen e paqes sociale dhe edukimin e brezëve me frymën e shenjtë të besimit dhe vlerave universale të tij.

Takimi vijoi me një bashkëbisedim të këndshëm rreth çështjeve me interes të përbashkët, ku Myftiu dhe Fortlumturia e Tij ishin të një mendimi për intensifikimin e takimeve, bashkëpunimit të mëtejshëm dhe rritjes së aktiviteteve të dobishme për të mirën e shoqërisë.

Në fund u këmbyen edhe dhuratat simbolike, si shenjë falënderimi dhe mirënjohjeje për këtë takim të përzemërt.



H. VEHBI S. GAVOÇI
(1923 - 2013)

“Kjo jetë është provim vetëm, s'ka pas saj provim tjetër!”

ALLAHU (xh.sh) NË KUR'ANIN E MADHËRUESHËM THOTË: “E KUR Ndonjërit prej tyre i vjen vdekja, ai thotë: 'Zoti im, më kthe, që të bëj vepra të mira e të kompensoj atë që lëshova'! KURRSESË, (KTHIM NUK KA) E kjo është vetëm fjalë që e thotë ai, e ata kanë para tyre një perde (distancë periodike) deri në ditën kur ringjallen. E kur i fryhet surit (herën e dytë) atëherë, në atë ditë nuk do të ketë lidhje familjare mes tyre e as që do të pyes kush por njëri-tjetrin. E kujt i peshojnë më rëndë peshojat (veprat e mira), ata janë të shpëtuarit, ndërsa, atyre që u peshojnë lehtë, peshojat (veprat e mira), ata janë që humbën vetveten dhe janë në xhehenem përgjithmonë!”

- (Kur'ani, El-Muminun: 99-103)

(Nga libri: Si forcohet e si vërtetohet besimi)



Naim Driaj

Imam - Xhamia Parrucë

Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Vërtet, imani vjetohet në zemrat tuaja ashtu si vjetrohen rrobat, andaj kërkoni prej Allahut t’juja ripërtërijë imanin në zemrat tuaja”.¹

Ky hadith thekson rëndësinë e imanit dhe tregon se ai mund të dobësohet dhe të konsumohet, ashtu siç vjetrohen rrobat nga përdorimi i vazhdueshëm. Pejgamberi (a.s) përdori këtë shembull të thjeshtë dhe të prekshëm për të ilustruar më mirë natyrën e imanit, në mënyrë që të kuptohet më lehtë. Përmes imanit, njeriu mund të jetojë një jetë të lumtur në këtë botë dhe të arrijë shpëtimin në botën tjetër.

Pse Pejgamberi (a.s) e krahasoi imanin me rrobat? Sepse ashtu siç ne kujdesemi që rrobat tona të jenë të pastra, sidomos në raste të veçanta ose kur kemi takime zyrtare, po ashtu duhet të kujdesemi për zemrën tonë, që të jetë e pastër dhe e shëndoshë. Rrobat vjetrohen dhe mund të ndoten nga përdorimi i vazhdueshëm, po ashtu edhe imani mund të dobësohet nëse nuk e ruajmë dhe forcojmë atë. Sikur të kujdesemi për imanin tonë ashtu si kujdesemi për rrobat tona, do t’i kishim

1. Transmeton Taberani dhe Hakimi.

RIPËRTËRITJA E IMANIT

punët shumë më mirë sesa i kemi.

Ibn Kajimi thotë: “Pema nuk mbetet gjallë pa e ujitur me ujë. Nëse nuk e ujit, ajo thahet. Po nëse e ujit, ajo bëhet pemë e shëndoshë dhe jep frytet e saja.” Kështu është edhe imani në zemrën e besimtarit. Nëse nuk e ushqen me punë dhe vepra të mira, ai thahet.

SI TA RIPËRTËRIJMË IMANIN?

Cilat janë ato vepra që, nëse i veprojmë, do të na mundësojnë ta ripërtërijmë dhe ta shtojmë imanin në zemrat tona?

1. Kërkimi i diturisë. Muslimani duhet të mësojë për fenë e tij, jo vetëm për të kuptuar çfarë është imani dhe Islami, por edhe për të ditur qëllimin e krijimit të jetës, pse jemi në këtë botë dhe shumë pyetje të tjera. Të gjitha përgjigjet i gjejmë në fenë tonë. Kur ne mësojmë për këto dhe shumë aspekte të tjera, imani ynë ripërtërihet.

2. T’i kushtojmë rëndësi fjalës së Allahut, Kur’anit, duke e lexuar dhe medituar në ajetet e tij.

Allahu (xh.sh) thotë: “Kur besimtarëve u lexohen ajetet e Kur’anit, u shtohet imani.”² Kur ne i kushtojmë vëmendje fjalës së Allahut, duke lexuar Kur’anin dhe medituar mbi ajetet e tij, imani ynë forcohet dhe rinovohet.

3. Mësimi i jetës së Pejgamberëve, dhe në veçanti i jetës së Pejgamberit tonë, Muhammedit (a.s), e ripërtërin imanin. Kur studion jetën e Pejgamberëve, veçanërisht të Muhammedit (a.s), kupton se çfarë vuajtjesh dhe sakrificash kanë bërë ata për ta sjellë këtë fe deri tek ne. Falë përpjekjeve të Pejgamberit (a.s), ne sot

themi: “La ilahe il-lallah Muhammedun rasulullah”.

4. Vazhdimësia në vepra të mira, veçanërisht falja e namazit.

Allahu (xh.sh) thotë: “Namazi të ruan nga veprat e këqija dhe të shëmtuara.”³ Kur falim namazin me sinqeritet, ai na mbron nga çdo veprim i keq dhe na pastron shpirtin. Namazi është një burim i fuqishëm për pastrimin e zemrës dhe forcimin e imanit. Duke u larguar nga veprat e këqija, zemra jonë mbushet me besim dhe iman, dhe çdo herë që i drejtohem Allahut në namaz, imani ynë rinovohet dhe forcohet.

5. Largimi nga gjynahet. Gjynahet e dobësojnë dhe zbehin imanin në zemrat tona. Çdo gjynah që bëjmë lë një pikë të zezë në zemrën tonë, dhe nëse nuk pendohemi për të, ajo pikë zgjerohet derisa mbulon tërë zemrën. Kur zemra mbushet me gjynahe, ajo bëhet më e fortë se guri dhe nuk ndjen më asgjë.

6. Lutja/Duaja. Duhet t’i lutemi Allahut sa më shumë që të na forcojë imanin tonë. Pejgamberi (a.s) shpesh lutej me këto fjalë: “O Ti që i rrotullon zemrat, ma forco zemrën time në fenë Tënde.”⁴ Lutja është një mjet i fuqishëm për të forcuar dhe rinovuar imanin. Kërkesa e sinqertë e zemrës nga Allahu na ndihmon që ta mbajmë besimin tonë të fortë dhe të qëndrueshëm në çdo moment të jetës. Allahu (xh.sh) në Suren Ali Imran na mëson se si t’i lutemi Atij, duke thënë: “O Zoti ynë! Mos lejo që zemrat tona të devijojnë (nga e vërteta), pasi na ke udhëzuar në rrugën e drejtë! Na dhuro mëshirën Tënde! Pa dyshim, Ti je Dhuruesi i madh.”⁵

3. Kur’ani, El-Ankebut: 45.

4. Transmeton Tirmidhiu.

5. Kur’ani, Ali Imran: 8.



Evans Drihti

Mësues - Medreseja "H. Sheh Shamia"

Në kohët kur flasim për adoleshencën dhe bëmat që sjell kjo fazë e rritjes së fëmijës, ndërkohë që tensionohemi nga kronikat e zeza, teksa shohim përplasje të panumërta të adoleshentëve, i kthehemi një pyetjeje të ftohtë, por mjaft koherente.

Nga burojnë të tilla reagime aspak të pranueshme, që sjellin të tilla përplasje deri në gjakosje të rënda?

Pa bërë filozofi dhe shkencë në të tilla trajtesa, hidhni syrin pak në vegjëlinë e fëmijëve, e veçanërisht, në moshën kur ata janë në fillore, apo siç njihet ndryshe Cikli i Ulët.

Po ju rikujtojmë!

Mos ta neglizhoni as si koncept dhe as si brendësi Ciklin e Ulët, pasi janë pikërisht sjellje dhe veprime që shfaqen në këtë periudhë, të cilat anashkalohen, kapërcehen, kapërdihen, shpërfillen, nënvlerësohen, manipulohen deri në një shpërfytyrim të padëshirueshëm vetëm e vetëm me idenë:

“Janë fëmijë, e s’janë të vetëdijshëm për sjellje të tilla!”

Kur fëmijët shtyjnë njëri-tjetrin si për argëtim, një të tillë sjellje ata e kthejnë në një “ves”, që me kalimin e kohës dhe me rritjen e tij, natyrshëm bëhet i bezdisshëm, shqetësues duke kapërcyer normat e një sjelljeje të hijshme.

RUAJUNI SJELLJEVE TË FËMIJËVE QË NË FILLORE...

Një “nofkë” e përfutur që në këto hapa, fillimisht si me ëmbëlsi, me kalimin e kohës kthehet në një burim keqtrajtimi, që çon natyrshëm në një cinizëm vulgar duke u kthyer në një “ves”.

Një “hingëllimë” apo një “pasthirmë” e pëshpëritur si në heshtje, me kalimin e kohës merr përmasa të gjera të një “loje argëtuese” duke u kthyer më pas në një “ves”.

Përmendja e emrave prindërorë, nis pikërisht në formë “loje” duke u shtrirë më pas në mënyrë tendencioze për të shkaktuar përplasje të qëllimshme mes shoqërisë duke marrë përmasat e një “vesi” cinik dhe ofendues.

Gjestet e shumta që përftohen nëpërmjet mimikave të fytyrës marrim kuptime dhe nuanca domethënëse në varësi të situatave dhe rrethanave që kërkohet të krijohen, e si të tilla, me kalimin e kohës “përvetësohen” duke marrë përmasën e një “vesi”.

Vini re sa herë “shqyhen” fletët e fletoreve, në të cilat bëhen vizatime nga më absurdet, të mësuara kuptohet nga Tik-Toku apo “Instagrami”, të cilat përcillen nga njëra bankë në tjetrën në idenë e një loje, që merr përmasa bullizuese duke u kthyer në “vese”.

Vini re gjestet që bëhen duke përdorur këmbë e duar në situata apo rrethana të krijuara me kurdisje therëse, me qëllim tensionimin e një situatë duke u kthyer kështu me kalimin e kohës në një “ves” cinik dhe denigrues.

Në të tilla raste e në sa e sa të tjera, nëse mësuesi, drejtorja e shkollës dhe natyrshëm vetë prindërit i shohin dhe “i pranojnë me buzagazje”, fëmija me instinktin e vet ka për detyrë ta marrë dhe ta pranojë “një sjellje” të tillë si “të natyrshme”, “të zakonshme”, “të pranueshme” e mbi të gjitha ARGËTUESE duke e vijuar këtë lojë akoma edhe më

shtruar, më bindshëm dhe më fuqishëm.

Kur fëmija më vonë, me mbarimin e Ciklit të Ulët shkon në klasat e 9-vjeçares duke i vijuar me plot natyrshmëri të tilla “gjeste”, haset me disa reagime të mësuesve për një papëlqyeshmëri të këtyre veprimeve, fëmija nis reagimin e parë me pyetjen: “Po ç’bëra unë?”, gjithnjë me mendjen e tij fëmijore, sipas së cilës të tilla gjeste i kam bërë shumë më herët, por askush nuk më kthjelloi dhe as më këshilloi. Kur kalohet më pas në gjimnaz, ky “ves” ka lëshuar rrënjë në thellësi tokësore dhe karakteriale të paperceptueshme duke u bërë jo vetëm i papërbalueshëm, por edhe lëndues deri në vrasar.

Ndaj,

Ruajuni sjelljeve dhe gjesteve të papëlqyeshme të fëmijëve të shfaqura që në bankat e para të shkollës, në mënyrë që me rritjen e tyre “mos të kapni kokat me grushta”.

Tregohuni të kujdesshëm t’i tërhiqni vëmendjen në kohën dhe vendin e duhur duke e bindur se ai “ves” mbetet i papëlqyeshëm dhe lëndues për tjetrin.

Mos e trajtoni fëmijën si “shokun tuaj”, pasi mendja fëmijore është e brishtë dhe gjithçka e merr “të pranueshme”.

Fëmija kërkon një vëzhgim të vazhdueshëm shoqëruar me orientime të vlefshme dhe kurajuese, të cilat do i japin kënaqësi për veprimin e bukur që kryen.

Ju rikujtojmë filmin “Adoleshenca” që mori përmasa botërore, se si u shfaq adoleshenti katërmëdhjetë vjeçar, i hekurt në qëndrimin e tij duke mos iu dridhur as qerpiku. Këtë tip adoleshenti sot e kemi të kudondodhur në institucionet tona arsimore, e për rrjedhojë në gjirin e familjes. Siç shprehet edhe populli: “I jep gishtin, të merr edhe krahun!”



Arben Halluni, teolog

ETAPAT E BESIMIT HYJNOR

(Evolucioni i Akides Ilahije)

Në fazën e dytë, megjithëse zotat mbeteshin të shumtë, njëri prej tyre dallohej dhe kishte përparësi ndaj të tjerëve. Ky ishte zakonisht zoti i fisit kryesor, ose i mbretërisë sunduese, ndaj të cilit mbështeteshin në çështjet e luftës, mbrojtjes dhe jetesës. Ai shihej si zot më i fuqishëm, më i madh dhe më i aftë për t'i përmbushur kërkesat, ndërsa zotat e tjerë kishin role dytësore.

3. Etapa e monoteizmit

Në fazën e tretë, populli bashkohej rreth adhurimit të një Zoti të vetëm, ndërkohë që pranonte ende ekzistencën e zotave të tjerë në rajone apo popuj të ndryshëm. Në këtë etapë ndodhte që një popull t'ua impononte adhurimin e zotit të vet të tjerëve, ashtu siç u impononte edhe pushtetin, fronin dhe autoritetin e tij.

DUALIZMI DHE PANTEIZMI

Sipas mendimit më të përhapur te dijetarët e krahimit të feve, dualizmi (Dualism) shpesh vjen pas monoteizmit në formën e tij të paplotë. Ky besim pranon ekzistencën e dy fuqive: një të mirës dhe një të keqes, ose dy hyjnive që ndajnë pushtetin mes tyre. Sipas tyre, njeriu në këtë fazë përpiqet ta shpjegojë të keqen në ekzistencë duke ia atribuuar një hyjnie tjetër, përveç Zotit të së mirës.

Më pas shfaqet panteizmi (Panteism), i cili përpiqet t'i pajtojë kundërshtitë dhe domosdoshmëritë, duke e vërtetuar ekzistencën e Zotit

përmes argumentit të qenies së gjithësisë, të ndjerë dhe të perceptuar nga shqisat, mendja dhe përvoja.

FORMAT E HYJNIVE TE POPUJT E LASHTË

Megjithëse hyjnitë e popujve të lashtë kishin forma dhe etapa të ndryshme, ato mund të përmbledhen në këto lloje:

1. Hyjnitë e natyrës: që mishëronin dukuritë natyrore si errësira, drita, agimi, shiu, stuhia, detet, burimet, dielli, hëna, qielli dhe pranvera.

2. Hyjnitë njerëzore: heronj, mbretër dhe udhëheqës të fuqishëm, të cilëve u atribuohet aftësia për mrekulli.

3. Hyjnitë e familjes dhe paraardhësve: stërgjyshër të nderuar që përkujtoheshin me festa, rite dhe fljime, dhe u atribuohet ndikim në jetën e pasardhësve.

4. Hyjni funksionale: si zoti i dashurisë, i luftës, i gjuetisë, i drejtësisë, i mirësisë dhe i paqes.

5. Hyjnitë e shtëpisë dhe jetës së përditshme: zoti i zjarrit, i detit, i tokës, i ushqimit etj.

6. Hyjnitë e pjellorisë dhe bereqetit, zakonisht në formë femërore, që më pas u shndërruan në mite dhe iluzione për jetën pas vdekjes.

7. Hyjnia krijuese, të cilës i atribuohet krijimi i qiellit, tokës, njeriut dhe kafshëve.

8. Hyjnia e lartë, që adhurimi i saj shoqërohej me ligje morale, vlera të larta etike dhe premtimin e lumturisë së përjetshme për shpirtat.

Kjo fazë përfaqëson nivelin më të lartë që ka arritur gjuha fetare e njerëzimit, dhe përgatitjen për besimin në një Zot të vetëm të përbashkët për të gjitha krijesat, pa përjashtim.

SHEMBUJ HISTORIKË

Tek disa fise afrikane edhe sot gjejmë gjurmë të këtyre fazave, ku njihen hyjni të shumta, por mbi të gjitha pranohet një Zot i Lartë, Atë i të gjithë zotave.

Edhe te arabët para Islamit, megjithëse adhuronin idhuj, ata besonin në Allahun (xh.sh), e quanin veten pasardhës të Hz. Ibrahimit (a.s), i emërtinonin fëmijët e tyre "Abdullah" dhe "Abdul-...", dhe pohonin se idhujt i adhuronin vetëm për t'u afruar tek Allahu Madhniplotë.

Po ashtu, bijtë e Izraelit, pas adhurimit të Allahut të Vetëm, ranë në adhurimin e viçit, dhe e quajtën Zotin me emrin El, Eloh ose Elohim, ku shumësi përdoret si shenjë madhërimi.

Zhvillimi fetar në besime është një realitet i pamohueshëm, por ai nuk ka qenë një rrugë lineare dhe e njëtrajtshme, ku etapet pasojnë njëra-tjetrën në mënyrë të rregullt. Përkundrazi, ai ka qenë një proces i ndërlikuar, ku nga njëra anë ka pasur ngritje e nga ana tjetër rënie.

Megjithatë, vëzhgimet që kanë përmbledhur dijetarët e krahimit të feve bien dakord në disa përfundime të përgjithshme, ndër to:

- Se besimi në shpirta ka qenë i përhapur në të gjitha shoqëritë primitive;

- Se popujt që e kanë kaluar këtë fazë dhe kanë hyrë në etapa qytetërimi e shtetformimi nuk kanë qenë të lirë nga format e adhurimit natyror, si adhurimi i dukurive qiellore dhe planetëve, veçanërisht i diellit, hënës dhe yjeve të njohur;

- Se adhurimi i paraardhësve ka qenë i pranishëm në forma të ndryshme, duke u përshtatur me nivelin e dijes dhe qytetërimit të secilës shoqëri.

TEUHIDI – PËRFUNDIMI I NATYRSHËM I ZHVILLIMIT FETAR

Teuhidi përfaqëson kulmin përfundimtar të të gjitha këtyre etapave në të gjitha qytetërimet e mëdha. Çdo

civilizim që arriti këtë fazë besoi në një Zot të vetëm, i cili ngrihet mbi të gjitha hyjnitë për nga fuqia, pushteti dhe sovraniteti, ndërsa zotat e tjerë u zhdukën, ose mbetën vetëm si figura dytësore, pa ndikim real, nën hijen e Arshit të Zotit të Lartë.

VEÇORIA E FEVE QIELLORE

Feja qiellore, pas gjithë këtij procesi, arriti në teuhid të pastër dhe të lartë. Ajo ia mësoi njerëzimit adhurimin e Zotit El-Ehad (Një i Vetëm), i Cili krijoi ekzistencën nga asgjëja, dhe fuqia e Tij përfshin gjithçka në qiej dhe në tokë. Ai nuk ka ortak as në krijim dhe as në drejtim.

Ky teuhid nuk lindi nga bashkimi politik i shtetit, nuk ishte rezultat i unifikimit shoqëror, as nuk e shpjegonte krijimin si transformim të një lënde të përhershme që nuk ka nevojë për Krijues. Përkundrazi, feja qiellore e paraqiti krijimin si akt hyjnor të qëllimshëm, të bazuar në urtësi dhe vullnet.

Sipas këtij kuptimi, krijimi i qiejve dhe i tokës nuk shihej si materie e verbër e jo si rastësi, por si realitet i rregulluar, i bukur dhe i përsosur. Njeriu nuk i shihte më gjërat si të panevojshme për renditje dhe koordinim, por si vepra të një Krijuesi të Urtë.

Nga kjo, njerëzit nxorën modele prodhimi dhe ndërtimi sipas rendit hyjnor, duke imituar rregullin e krijimit në veprat e tyre, ndërsa mendja njerëzore mbeti e kufizuar brenda këtij horizonti deri në ardhjen e doktrinës greke dhe më pas të krishterimit.

SHEMBULLI I GREKËVE TË LASHTË

Tek grekët, Zeusi nuk ishte krijuesi i universit nga hiçi, as Zot i qiellit dhe tokës në kuptimin absolut, por figura më e lartë familjare, babai i perëndive dhe njerëzve, ose sundimtari i ndihmësve dhe pasuesve. Kjo përfaqësonte një fazë mendore të ndërmjetme, ku filozofët, me gjithë përpjekjet e tyre, nuk arritën të depërtojnë te ideja e krijimit absolut.

Ata kërkuan origjinën e parë të materies, por e konsideronin ekzistencën e saj si të pavarur dhe jo të krijuar nga jashtë saj.

Kur njeriu e braktisi këtë mënyrë të të menduarit dhe filloi të reflektojë thellë mbi krijimin e gjithësisë, u hap rruga drejt njohjes së Zotit të Vërtetë, i Cili krijon, rregullon dhe sundon çdo gjë me urtësi dhe fuqi absolute...



Pejgamberi (a.s) ka thënë:

“

Pas jush do të ketë ditë, durimi në to është sikur mbajtja e gacës (thëngjillit të ndezur).

Atij që punon në to (në ato ditë) ka shpërblim sikur shpërblimi i pesëdhjetë burrave, që punojnë si punën tuaj".

I thanë: O i Dërguar i Allahut, shpërblimi i pesëdhjetë prej tyre apo prej nesh?

Tha: "Jo, shpërblimi i pesëdhjetëve prej jush".



(Transmetuar nga Tirmidhiu)

KUR NJERIU E BRAKTISI KËTË MËNYRË TË TË MENDUARIT DHE FILLOI TË REFLEKTOJË THELLË MBI KRIJIMIN E GJITHËSISË, U HAP RRUGA DREJT NJOHJES SË ZOTIT TË VËRTETË, I CILI KRIJON, RREGULLON DHE SUNDON ÇDO GJË ME URTËSI DHE FUQI ABSOLUTE...





MSc. Zamira Bushati (Puka),
Teologe, vaize

GJUHA ARABE: BESIM, MENDIM DHE QYTETËRIM

Arabishtja quhet ndryshe edhe si Gjuha e Dadit, ngaqë është e vetmja gjuhë në botë që ka shkronjën “dad”. Alfabeti i saj ka 28 shkronja duke e konsideruar nga të paktat gjuhë në botë me numër të paktë të shkronjave. Gjuha Arabe dhe Urdishtja shkruhen nga e djathta në të majtë, ndryshe nga gjuhët e tjera të cilat shkruhen nga e majta në të djathtë.

Fonetikisht, arabishtja dallon për tingujt e veçantë, përfshirë bashkëtingëlloret e fytit dhe të forta, të cilat mungojnë në shumë gjuhë të tjera. Bashkëtingëlloret e fytit (guturale), si ح, ع, غ, غ, si shqiptohen në pjesën e pasme të fytit dhe i japin thellësi shqiptimit, ndërsa bashkëtingëlloret e forta (emfatike), si ض, ط, ظ, si shqiptohen me theks dhe forcë të veçantë, duke i dhënë fjalës ngjyrë dhe intensitet. Kombinimi i këtyre tingujve krijon një jehonë dhe ritëm të veçantë, që e bën gjuhën të këndshme për recitim dhe të fuqishme në shprehje, duke e bërë arabishten jo vetëm të qartë në kuptim, por edhe të gjallë dhe të ndjeshme në tingull.

Ajo karakterizohet për forcën e strukturës së fjalëve të saj, gjë të cilën nuk e has me asnjë gjuhë tjetër. Shkronjat e saj, të cilat dalin nga brenda dhe jashtë gojës formojnë një variete muzikore të cilën nuk e gjen në asnjë gjuhë tjetër.

Një nga veçoritë e gjuhës arabe është sistemi i saj rrënjor (root-and-pattern system), në të cilin shumica e fjalëve ndërtohen mbi rrënjë prej tri shkronjash që mbartin kuptimin themelor. Ky sistem krijon lidhje të brendshme logjike mes fjalëve dhe ideve, pasi nga e njëjta rrënjë lindin dhjetëra forma të ndryshme, secila me nuancën e vet semantike, duke e ushtruar mendjen në analizë, krahasim dhe thellim konceptual. Kështu, nga rrënja ك-ت-ب (k-t-b) formohen terma të ndryshëm që lidhen me aktin e shkrimit, si ketebe (ai shkroi), kitāb (libër), kutub (libra), kاتب (shkrimtar), mekteb (zyrë ose bibliotekë) dhe mektūb (e shkruar, letër). Kjo pasuri morfologjike dëshmon se dija, në vetë strukturën e gjuhës, nuk paraqitet si gjendje statike, por si proces dinamik dhe i vazhdueshëm.

Gjithashtu, foljet me rrënjë të ngjashme në arabisht kanë kuptime të ngjashme, që nuk gjenden në gjuhë të tjera: p.sh. folja قطع (nëse ndryshohet vetëm shkronja e fundit, thuhet: قطع. قطع. قطع. Në këto fjalë, do të gjejmë një kuptim të përbashkët, atë të kafshimit/ndarjes të diçkaje në copa.

Në arabisht kuptimi ndërtohet me saktësi dhe harmoni, ku çdo ndryshim i vogël në formë sjell ndryshim në domethënie. Kjo gjë e ka bërë atë një gjuhë ideale edhe për teologji, jurisprudencë dhe etikë, në të cilën qartësia nuk është luks, por domosdoshmëri.

Fjalori i saj është i bollshëm dhe çdo sinonim ka një kuptim të ri. Nuk ka kafshë, objekt të pajetë apo bimë që nuk ka shumë emra dhetribute, gjë që tregon pasurinë e kësaj gjuhe të mrekullueshme. Fjalori Lisanul-Arab i përpiluar nga Ibn Mandhuri, përmban mbi 80,000 fjalë. Gjithashtu orientalisti japonez Izutsu, është shprehur se: “Edhe pasuria mahnitëse e fjalorit arab shpreh të gjitha aspektet e dukshme të të gjitha gjërave konkrete.”¹

Orientalisti Gustav Grunebaum (1909 – 1972) ka thënë: “...Asnjë gjuhë nuk mund të rivalizojë gjuhën arabe në fisnikërinë e saj. Është mjeti i zgjedhur për të përcjellë mesazhin e fundit të Zotit. Statusi i saj shpirtëror nuk është i vetmi faktor që e ngre atë mbi fuqinë dhe elokuencën që Zoti u ka dhënë gjuhëve të tjera. Sa i përket gjerësisë së saj, ajo është e qartë, sepse kushdo që shqyrton të gjitha gjuhët nuk do të gjejë, për aq sa kam dëgjuar, një gjuhë që rivalizon arabishten. Bukuria e tingullit i shtohet pasurisë së saj të mahnitshme të sinonimeve, si dhe saktësia e qartësia e shprehjes e zbukurojnë gjuhën arabe. Ajo dallohet për lehtësinë e saj të pakrahasueshme në përdorimin e metaforës, por edhe dhe bollëku i metonimive, krahasimeve dhe alegorive e ngre atë shumë lart mbi çdo gjuhë tjetër njerëzore. Kjo gjuhë zotëron karakteristika të shumta stilistike dhe

1. Izutsu, Toshihiko. God and Man in the Qur'an: Semantics of the Qur'anic... Keio University 1964, Minatoku, Tokyo, Japan; Second reprint 2008, Published by Islamic Book Trust, Jalan Othman, Malaysia, p.56.

gramatikore, të cilat nuk gjenden në asnjë gjuhë tjetër. Pavarësisht kësaj gjerësie dhe pasurie, ajo është gjuha më koncize në përcjelljen e kuptimit dhe transmetimin e tij. Kjo tregon se versioni arab i çdo proverbi të huaj është më i shkurtër në të gjitha rastet.”²

GJUHA ARABE: GJUHA E BESIMIT, MENDIMIT DHE QYTETËRIMIT

Gjuha arabe është pjesë e pandarë e dimensionit të besimit. Ajo është gjuha në të cilën u shpall Kur'ani – jo rastësisht, por për shkak të kapacitetit të saj të jashtëzakonshëm shprehës. Kur'ani vetë e thekson këtë: “Ne e zbritëm Kur'anin, në gjuhën arabe, për ta kuptuar.” - (Kur'ani, Jusuf: 2)

Besimi, në gjuhën arabe, nuk kuptohet si një ndjenjë e paqartë apo thjesht emocionale, por ndërtohet mbi një sistem të qëndrueshëm dhe të ndërlidhur konceptesh si iman, islam dhe ihsan, ku secili term mbart një horizont të gjerë kuptimor. Kjo thellësi konceptesh lidhet ngushtë me një vazhdimësi të rrallë tekstuale, pasi Kur'ani dhe korpusi i gjerë i veprave të shkruara, që nga shekulli i shtatë, vazhdojnë të lexohen e kuptohen edhe sot, me stabilitet të lartë semantik dhe gramatikor. Pikërisht kjo vazhdimësi e bëri arabishten një gjuhë reference për shekuj me radhë, duke e shndërruar në gjuhën e besimit, të administratës, të filozofisë dhe të shkencës nga Andaluzia deri në Bagdad, ku në periudhën klasike islame ajo u konsolidua si “gjuha e dijes”, përmes së cilës u ruajt trashëgimia greke dhe u zhvilluan disiplina të reja shkencore. Esh-Shatibiu (1320–1388 e.s) thotë: “Nëse supozojmë se dikush është fillestar në të kuptuarit e arabishtes, ai është fillestar edhe në të kuptuarit e ligjit islam; ose dikush me aftësi mesatare, ai ka aftësi mesatare edhe në të kuptuarit e ligjit islam, sepse personi me aftësi mesatare nuk e arrin nivelin e përfundimtar. E kur të arrijë nivelin e lartë në arabisht, atëherë ai do të arrijë të njëjtin nivel edhe në ligjin islam dhe kuptimi i tij do të jetë argument për të...”³

Kjo lidhje organike mes gjuhës dhe besimit ka prodhuar një traditë të pasur

2. El- Khundi, Enver. El-Fus'ha lugatul-Kuran, Darul-Kitab El-Lubnani ve Mektebetul-Medrese, 1982, Bejrut, Liban, fq. 306.
3. Esh- Shatibi, Ebi Is'hak, El-muvafekat; Menshurat El-Beshir, Fes, Marok, 2017, vëll. 5, fq. 59-60.

të të kuptuarit, ku analiza gjuhësore është themeli i interpretimit fetar. Shkencat islame klasike si tefsiri, hadithi dhe fikhu janë ndërtuar mbi parimin, se kuptimi i shpalljes zbulohet përmes njohjes së hollësishme të gjuhës arabe, të gramatikës, retorikës dhe përdorimit sipas kontekstit. Në këtë kuptim, arabishtja nuk është vetëm gjuhë e adhurimit, por instrument metodologjik i dijes fetare. Imam Shafiu (767–820 e.s) thotë: “Unë nuk pyetem për një çështje të jurisprudencës (Fikhut) përveçse i përgjigjem asaj me anë të rregullave të gramatikës”⁴

Shejhu Ibn Tejmije (Zoti i Plotfuqishëm e mëshiroftë) thotë: “Dije se njohja e gjuhës ka një efekt të fortë dhe të qartë në mendje, në karakter dhe në fe. Gjithashtu ndikon në ngjashmërinë me brezat e hershëm të këtij ymeti, me sahabët dhe tabiinët. Kjo ngjashmëri me ta rrit përcëptimin, forcon fenë dhe karakterin.”⁵

Në planin e mendimit intelektual, gjuha arabe u shndërrua në medium universal të filozofisë dhe shkencës gjatë mesjetës. Vepra në mjekësi, matematikë dhe astronomi u shkruan në arabisht dhe më pas u përkthyer në latinisht, siç dëshmohej me veprat e El-Farabiu, Ibn Sinës, Ibn Rushdit, etj. Prandaj arabishtja nuk është thjesht trashëgimi islame, por trashëgimi universale. Kimisti dhe historiani belgo-amerikan George Sarton (1884-1956) thekson se “nga gjysma e shekullit të 8të deri në fund të shekullit të 11të, arabishtja ishte gjuha shkencore dhe progresive e njerëzimit, dhe se kur Perëndimi kërkoi njohuri më të thella, ai u drejtua së pari jo tek burimet greke, por tek ato arabe.”⁶

Gjithashtu, kur veprat e Aristotelit, Platonit dhe Galenit u përkthyer në arabisht, ato u integruan në një horizont të ri kulturor, ku konceptet filozofike u ripunuan përmes strukturës semantike arabe. Dimitri Gutas argumenton se: “Lëvizja e përkthimeve nuk ishte një akt i thjeshtë transmetimi, por një proces kompleks i transformimit kulturor dhe

intelektual.”⁷

Kur besimi dhe mendimi gjejnë gjuhën e duhur, lind qytetërimi. Prandaj arabishtja u shndërrua në gjuhën e qytetërimit islam, ku ndikimi i saj shkoj përtej kufijve fetarë. Ajo u bë gjuha e mjekësisë, matematikës, astronomisë dhe filozofisë, duke ndikuar drejtpërdrejt në formimin e Evropës mesjetare.

Prandaj, gjuha arabe ka vepruar si një urë që lidh kultura dhe popuj të ndryshëm, duke krijuar një hapësirë të përbashkët, ku diversiteti nuk u shua, por u organizua brenda një qytetërimi me bosht etik. Civilizimi islam nuk ishte një strukturë homogjene, por një mozaik dinamik i traditave dhe identiteteve të ndryshme, ku arabishtja shërbente si mjet komunikimi intelektual dhe shkencor, një medium i bashkëpunimit filozofik dhe estetik që nxiste dialogun ndërkulturor. Ismail Raxhi El-Faruki (1921-1986) argumenton se: “Arabishtja, përkundër funksionit të saj unifikues, nuk fshihi diversitetin, por e sistemoi atë brenda një qytetërimi ku vlerat morale, estetike dhe intelektuale formësuan një bashkëpunim kompleks kulturor, duke ofruar një platformë për dialog ndërmjet civilizimeve të ndryshme.”⁸

Orientalisti italian Carlo Nallino (1872-1938) ka thënë: “Arabishtja i tejkalon të gjitha gjuhët e tjera në shkëlqim dhe pasuri, duke bërë që gjuha të jetë e paaftë të përshkruajë bukuritë e saj.”⁹

Në përfundim, gjuha arabe nuk mund të reduktohet në një mjet komunikimi apo në një trashëgimi fetare statike. Ajo është një strukturë dinamike që ka ndërtuar besim, ka formësuar mendim dhe ka krijuar një qytetërim me ndikim global. Për këtë arsye, gjuha arabe mbetet një nga fenomenet më të rëndësishme kulturore dhe intelektuale të historisë njerëzore. Duke e studiuar dhe vlerësuar atë, ne nuk po ruajmë vetëm një gjuhë, por po ruajmë një mënyrë të thellë të të menduarit njerëzor.

(Referat i mbajtur në aktivitetin e zhvilluar, më 18 dhjetor 2025, me rastin e Ditës Botërore të Gjuhës Arabe)

7. Gutas, Dimitri, “Greek Thought, Arabic Culture”, Routledge, London, 1998, fq. 2.
8. Shih: <https://ismailfaruqi.com/>
9. El- Khundi, Enver. El-Fus'ha lugatul-Kuran, Darul-Kitab El-Lubnani ve Mektebetul-Medrese, 1982, Bejrut, Liban, fq.308.

KENIA OSE REPUBLIKA E KENIAS

Kenia, zyrtarisht Republika e Kenias, është një vend që gjendet në Afrikën Lindore, dhe kufizohet me Sudanin e Jugut dhe Etiopinë në veri, me Somalinë dhe Oqeanin Indian në lindje dhe juglindje, me Tanzaninë në jug dhe me Liqenin Viktoria dhe Ugandën në perëndim. Vendi ndahet pothuajse përmes, horizontalisht, nga Ekuatori.

Kryeqyteti dhe qyteti më i madh i Kenias është **Nairobi**. Qyteti i saj i dytë më i madh dhe më i vjetër është Mombasa, një qytet port i madh i vendosur në ishullin Mombasa.

Kenia ka një sipërfaqe prej 580,367 km² dhe një popullsi prej 52,428,290 banorësh (viti 2024).

GJEOGRAFIA

Nga brigjet e Oqeanit Indian në juglindje, lartësia vjen duke u rritur gradualisht drejt Malësive Qendrore, ku gjendet edhe maja më e lartë e vendit, Mali Kenia, me 5199 m mbi nivelin e detit, dhe e dyta më e larta në kontinent; ky mal është vendi i akullnajave të përhershme. Më në perëndim ngrihen vargmalet Aberdare, me lartësi rreth 4000 m mbi nivelin e detit. Malësia Qendrore përhapet si një mantel gjigant në të dy anët e maleve Aberdare, të cilat shtrihen në veri më shumë se 100 milje nga Nairobi. Kjo është një zonë me tokë të pasur bujqësore dhe pyje të dendura, dhe prodhimet bujqësore kryesore që prodhohen atje janë kafeja, çaji, misri, prodhimet e kopshtarisë si lulet dhe bishtajat, dhe piretrumi (i përdorur në insekticide).

Lugina e Riftit të Madh është një linjë thyerjeje masive në sipërfaqen e tokës, që i kalon 5000 km gjatësi, nga Jordania e largët në veri, pastaj arrin përmes Kenias, e deri në Mozambik në jug. Lugina e Riftit të Madh i ndan malësitë keniane në lindore dhe perëndimore, duke krijuar një tjetër veçori të gjeografisë së vendit. Brenda Luginës së Riftit të Madh të Kenias shtrihet një zinxhir prej tetë liqenesh të formave dhe përbërjeve të ndryshme, një nga të cilët është liqeni Turkana, i karakterizuar nga ngjyra e tij e gjelbër; ky është liqeni më i madh në shkretëtirë, në botë. Liqeni Viktoria, nga ana tjetër, është liqeni i dytë më i madh në botë me

ujëra të ëmbla dhe ndahet mes Kenias, Ugandës dhe Tanzanisë. Pellgu i liqenit dominohet nga fushat e Kanos, të cilat janë të përshtatshme për bujqësi.

Shkretëtirat e gjera të thata dhe gjysmë të thata të rajoneve veriore të Kenias zënë rreth 200,000 km² të territorit të vendit. Në këtë rajon bien reshje minimale, kështu që, këto toka janë shtëpia e nomadëve të guximshëm, të cilët numërohen të jenë më pak se një e pesta e popullsisë së përgjithshme të Kenias.

Zonat jugore janë të pasura me burime blegtorale dhe kafshë të egra, dhe janë të famshme për rezervatin

dhjetor, është sezoni i “shirave të shkurtra”. Reshjet ndonjëherë janë të mëdha dhe shpesh bien pasditeve dhe mbrëmjeve. Ndryshimet klimatike po ndryshojnë modelin natyror të periudhës së reshjeve, duke shkaktuar një zgjatje të reshjeve të shkurtra, të cilat kanë shkaktuar përmbajtje, dhe duke reduktuar ciklin e thatësirës nga ‘një herë në çdo dhjetë vjet’ në ‘ndryshime vjetore’, duke prodhuar kështu thatësira të forta.

Temperatura gjatë muajve të shiut tropikal mbetet e lartë. Periudha më e nxehtë në Kenia është në muajt shkurt-mars, duke çuar në sezonin e shirave të



Maasai Mara, i cili përbën një pjesë të migrimin monumental të bletëve të egra.

KLIMA

Klima e Kenias ndryshon nga tropikale përgjatë bregdetit, në të butë në brendësi, e deri në të thatë në pjesët veriore dhe verilindore të vendit. Territori merr shumë diell çdo muaj. Zakonisht, në brendësi të tokës në lartësi, gjatë natës dhe herët në mëngjes bën freskët.

Në periudhat mars-prill dhe maj-qershor është sezoni i “shirave të gjata”, kurse nga tetori deri në nëntor-

gjata, kurse periudha më e ftohtë është nga korriku deri në mes të gushtit.

EKONOMIA

Ekonomia e Kenias është një ekonomi tregu, me disa ndërmarrje shtetërore. Kenia ka një treg në zhvillim dhe është një vend mesatarisht i industrializuar, përpara vendeve të tjera të Afrikës Lindore. Aktualisht është një vend me të ardhura mesatare të ulëta, por synon të bëhet një vend i ri i industrializuar deri në vitin 2030. Industrinë kryesore që nxisin ekonominë keniane përfshijnë shërbimet financiare, bujqësinë,

pasuritë e paluajtshme, prodhimin, logjistikën, turizmin, tregtinë me pakicë dhe energjinë.

Që nga viti 2020, Kenia ka pasur ekonominë e tretë më të madhe në Afrikën Sub-Sahariane, pas Nigerisë dhe Afrikës së Jugut. Në nivel rajonal, Kenia ka pasur një ekonomi më të fortë dhe më të qëndrueshme krahasuar me vendet fqinje të Afrikës Lindore. Deri në vitin 2023, vendi ishte kthyer në qendrën më të madhe të start-up-eve në Afrikë, si për nga fondet e investuara, ashtu edhe për nga numri i projekteve. Partnerët kryesorë tregtarë të Kenias janë Anglia, Japonia, Gjermania dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Bujqësia është kontribuuesi më i rëndësishëm në Kenia, duke kontribuar më shumë se një të tretën e prodhimit ekonomik të vendit dhe duke punësuar më shumë punëtorë se çdo aktivitet tjetër ekonomik në vend. Prodhimi i kafesë është burimi më i rëndësishëm i të ardhurave të vendit. Prodhime të tjera të rëndësishme për ekonominë e vendit janë pambuku, ananasi, kallam sheqeri, çaji, etj. Kultura më e rëndësishme lokale për ushqyerje të përditshme është misri i verdhë. Prodhime të tjera lokale përfshijnë bananet, fasulet, kasavan, patatet, patatet e ëmbla dhe grurin.

Shumica e fermerëve kenianë zotërojnë fermat në të cilat punojnë ose i marrin me qera nga qeveria. Shumica e fermave janë të vogla, por ka edhe ferma të mëdha që prodhojnë kafe dhe çaj për tregtim.

Profesioni i bariut është gjithashtu mjaft i rëndësishëm në Kenia, ku gjenden rreth 11 milionë bagëti, 9 milionë dhi dhe dele, dhe ku rriten edhe deve.



XHAMIA E MADHE, NAIROBI



KRYEQYTETI, NAIROBI

Produktet industriale kryesore të Kenias janë çimentoja, kimikatet, pajisjet shtëpiake, makineritë e lehta, automobilat, produktet e letrës, letra dhe tekstilet. Përpunimi i ushqimit përbën një aktivitet të rëndësishëm industrial në Kenia. Në Mombasa gjendet një rafineri naftë e cila përpunon naftën e importuar. Dy qendrat më të rëndësishme industriale në Kenia janë: Nairobi dhe Mombasa. Kenia ka pak minerale të çmuara. Aktiviteti minerar është i përqendruar në prodhimin e sodës, fluorit të kalciumit kristalor, kripës, gurëve të çmuar dhe gjysmë të çmuar. Sektori i minierave ka një rëndësi të vogël për ekonominë keniane dhe i është lënë kryesisht sektorit privat, por qeveria vendos shumë rregullore dhe procedura për këtë lloj aktiviteti.

Turizmi është një aktivitet i rëndësishëm ekonomik në Kenia dhe kontribuon më shumë se çdo aktivitet tjetër ekonomik, përveç prodhimit dhe shitjes së kafesë. Më shumë se 500,000 turistë vizitojnë Kenian çdo vit, duke

shijuar peizazhin e bukur bregdetar dhe veçanërisht duke parë dhe fotografuar kafshë të egra në safari. Turizmi gjeneron mbi 200 milionë dollarë në vit. Turizmi gjithashtu ofron mundësi punësimi për më shumë se 40,000 kenianë.

HISTORI

Në shekullin e dytë pas Krishtit, përgjatë brigjeve të Kenias, së bashku me Tanzaninë, u përhapën qendrat tregtare, nga ku tregtohej me Kinën, Indinë, Indonezinë, Lindjen e Mesme, Afrikën e Veriut dhe Persinë. Në shekullin e 9-të, në atë zonë erdhën të banonin njerëz të etnive të tjera, si arabë, afrikanë dhe persianë, të cilët merreshin me tregti dhe të cilët u njohën si “Populli i Bregdetit” dhe gjuha e tyre quhej “Kisuhili”.

Kur filloi kolonizimi evropian i tokave afrikane, në shekullin e 15-të, Portugalia ishte vendi i parë që mbërriti atje, duke e bërë Mombasa-n bazën e saj dhe duke monopolizuar tregtinë në Oqeanin Indian, derisa u dëbua në shekullin e 17-të.

Në vitin 1890 rajoni u nda midis Gjermanisë dhe Mbretërisë së Bashkuar. Gjermania mori rajonin jugor së bashku me Tanzaninë dhe Burundin, ndërsa Anglia mori rajonin verior.

Në vitin 1895 Britania krijoi Protektoratin e Afrikës Lindore, e transformoi atë në një koloni në vitin 1920 dhe e quajti Kenia, sipas malit të saj më të lartë. Përplasjet politike midis kolonisë dhe Anglisë çuan në Kryengritjen e Mau Mau të vitit 1952, e cila përfundimisht çoi në shpalljen e pavarësisë së vendit në vitin 1963. Ikona e luftës së Kenias dhe “babai themelues” Xhomo Keniatta, e udhëhoqi

vendin nga pavarësia e deri në vdekjen e tij, deri në vitin 1978. Vendin e tij e zuri Daniel Arap Moi.

Më 26 mars 2025 Kenia njohu pavarësinë e Kosovës, gjë për të cilën populli shqiptar i është mirënjohës.

GJUHA

Dy gjuhët zyrtare në vend janë anglishtja dhe sevahili, të cilat përdoren për komunikimin mes etnive të shumta që jetojnë në Kenia. Grupet etnike të Kenias zakonisht flasin gjuhët e tyre amtare brenda komuniteteve të tyre. Anglishtja flitet gjerësisht në fushën e tregtisë, shkollim dhe në qeveri.

FEJA

Shumica e kenianëve janë të krishterë, me 85.5% të popullsisë.

Islami është feja e dytë më e madhe në vend, me 11% të popullsisë, ku shumica e tyre janë sunitë, kryesisht të shkollës juridike Shafi'i.

Pjesa tjetër e popullsisë u përkasin besimeve indigjene, hindu, budiste, etj.

SI ERDHI ISLAMI NË KENIA

Islami u përhap në të gjithë Afrikën Lindore në përgjithësi përmes emigrimit, tregtisë, krijimit të emirateve e mbretërive, dhe përmes predikimit. Ardhja e Islamit në Kenia ishte e hershme dhe daton nga shekulli i parë hixhri (shek. 8 e.j.). Pastaj, nga fundi i epokës Umejade, numri i muslimanëve u dynd dhe bregdeti kenian u bë një bregdet islam ku muslimanët krijuan qytete të përparura dhe e zhvilluan vendin përmes kultivimit të tokës, tregtisë e ndërtimit.

Gjurmët e qytetërimit islam vazhdojnë të ekzistojnë ende edhe sot në Kenia dhe Tanzaninë ngjitur saj, dhe dëshmojnë për ngritjen e shteteve dhe emirateve-principatave islame atje. Emirati i parë Islam në Kenia ishte ai "Lamu", i cili u themelua nga dy vëllezër nga fisi Ezd, nga Omani – Sa'idi dhe Sulejmani - djemtë e Abbad ibn El-Xhulandi. Ata ishin mbretër në Oman, por për shkak të rrethanave të luftës me Haxhaxh ibn Jusuf Eth-Thekafun, i cili dëshironte të impononte me forcë ushtarake pushtetin e shtetit të Beni Umejëve mbi Omanin, u detyruan ta lënë atdheun dhe të nisen me anije drejt bregut lindor të Afrikës. Së bashku me familjet e tyre dhe me burrat e ushtarët që i mbështetnin, ata mbërritën në ishujt e Arkipelagut Lamu, që sot ndodhet në territorin e shtetit të Kenias. Aty u vendosën dhe themeluan

një principatë të vogël, e cila pati një ndikim të rëndësishëm në përhapjen e Islamit mes banorëve vendas.

Hinchens ka hedhur më shumë dritë mbi këtë emigrim, kur gjeti një libër të shkruar nga Shibu Ferexh ibn Hamd El-Bakirij, me titullin: Lajme rreth Lamu-së, ku paraqet historinë e këtij vendi dhe valët e para të emigrimit që mbërritën atje. Ai përmend se emigrantët e parë u vendosën në qytetin Lamu, në veri të Mombasa-s, dhe se ata ishin shkak i themelimit të një principate islame në atë kohë, më e hershmeja ndër principatat islame atje.

Më mbrapa ndodhi një tjetër valë emigrimi drejt tokës së "Zinxhëve", emër që arabët i dhanë bregut lindor të Afrikës, dhe kjo ndodhi në vitin 111 hixhri – 729 e.j. Pastaj erdhën edhe emigrantët nga fisi Benu Nebhan nga Sultanati i Omanit, në qytetin Bata, i cili ndodhet në veri të qytetit Lamu, në Kenia.

Kështu, në bregdetin lindor të Afrikës, i njohur si "Toka e Zinxhëve", filluan të shfaqen principatat islame, dhe muslimanët atje ishin një përzjerje e afrikanëve, shirazëve dhe arabëve. Ky komunitet u quajtën "sevahilianë" (bregdetarë), dhe aty filloi të zhvillohej edhe gjuha sevahili, e cila mori si bazë alfabetin arab.

Thirrja Islame u përhap nga bregdeti në brendësi të kontinentit gjithashtu, nëpërmjet aktiviteteve tregtare të muslimanëve.

Udhëtari i famshëm maroken Ibn Batuta, i cili vizitoi bregdetin lindor të Afrikës në vitin 1331, citon se atje kishte një prani të fortë islame. Ai shkruante: "Banorët janë të dashur, fisnikë dhe të mirë, dhe kanë xhami prej druri të ndërtuara mirë".

Sot, muslimanët përbëjnë rreth 11% të popullsisë së Kenias, që do të thotë afërsisht 6 milionë muslimanë. Ata janë të përhapur në zonën bregdetare, në qytetet Bata, Lamu, Malindi dhe Mombasa. Po ashtu, ata janë të pranishëm edhe në brendësi të vendit, në Nairobi dhe rrethinat e tij, si dhe në rajonin kenian pranë kufirit me Somalinë dhe Ogadenin.

Përgatiti:

Msc. Arta Ujkaj, teologe

<https://tipyan.com>
<https://www.aljazeera.net>
<https://en.wikipedia.org>
<https://www.britannica.com>
<https://www.marefa.org>
<https://sabbq.org>

MYFTINIA SHKODËR URON BESIMTARËT ME RASTIN E FILLIMIT TË TRE MUAJVE TË MIRË 1447 H

“NUMRI I MUAJVE TEK ALLAHU ËSHTË DYMËDHJETË MUAJ, NË LIBRIN E ALLAHUT, QË DITËN QË KRIJOI QIEJT DHE TOKËN; PREJ TYRE, KATËR JANË TË SHENJTË. KJO ËSHTË FEJA E DREJTË, PRANDAJ MOS I BËNI ZULLUM (PADREJTËSI) NË TO VETES TUAJ...”.

– (Kur’ani, Et-Teube: 36)



Myftinia Shkodër njofton të gjithë besimtarët muslimanë të zonës së Shkodrës se sot e diel, më 21 dhjetor 2025, nis periudha e begatë e Tre Muajve të Mirë, Rexheb, Shaban dhe Ramazan 1447 H.

Me këtë rast, Myftinia Shkodër fton të gjithë besimtarët që të përgatitën shpirtërisht dhe të përpiqen me të gjitha mundësitë e tyre për të shprehur përkushtimin dhe angazhimin e tyre shpirtëror dhe material duke u angazhuar maksimalisht për të përjetuar këtë mirësi të madhe të Allahut (xh.sh), nëpërmjet përsosmërisë së adhurimeve, rregullimit të marrëdhënieve farefisnore, vizitave familjare, shtimit të dhikreve, leximit të Kur’anit, sadakasë, etj.

Myftinia Shkodër fton besimtarët që gjatë kësaj periudhe të shtojnë istigfarin (kërkimin falje para duarve të Allahut të Madhëruar), pendimin e sinqertë, rregullimin e marrëdhënieve me Zotin e gjithësisë për t’u afruar përherë e më tepër drejt dashnisë së Tij në pritje të muajit të madhnueshëm të Ramazanit.

Me zemër të mirë Tre Muajt e Mirë!

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara, Myftinia Shkodër mirëpret Mirënjohjen e Shoqatës së Para-Tetraplegjike Shkodër.

Në një kartolinë të dërguar nga Shoqata e Tetra-Plegjikëve Shkodër, drejtuesi i saj, Saimir Ustabeqiri shkruan:

“Një Mbështetje E Rëndësishme Për PAK Shkodër

Në këtë 3 Dhjetor — Ditën Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara, ju falënderojmë për punën tuaj të palodhur dhe përkushtimin për personat me aftësi të kufizuara.

Le të shërbejë kjo ditë si një ftesë për të rritur mbështetjen dhe shërbimet, duke ndihmuar secilin të shprehet dhe të zhvillohet plotësisht.

Ju kujtojmë se çdo përpjekje, çdo mundësi që ofroni, ndihmon ata të ndihen të barabartë dhe të përfshirë në shoqëri.

Me mirënjohje,

Shoqata Para-Tetraplegjike Shkodër”

Myftinia Shkodër, duke u nisur nga hadithi i të Dërguarit të Allahut (a.s): “Më i miri i njerëzve, është më i dobishmi për njerëzit!” i bën thirrje në radhë të parë institucioneve vendore dhe qendrore,

besimtarëve dhe qytetarëve, të mos kursehen për të kontribuar në shërbim të vëllezërve dhe motrave antarë të Shoqatës së Para-Tetraplegjike Shkodër, të cilët kanë nevojë për ndihmën tonë,

në mënyrë që të ndjehen të barabartë si gjithë njerëzit e tjerë.

Allahu i Madhëruar i shpërbleftë me të mira, të gjithë bamirësit!

SHOQATA PARA-TETRAPLEGJIKE SHKODËR, MIRËNJOHJE PËR MYFTININË SHKODËR



VIZITË E DELEGACIONIT TË XHAMISË “DRITA”, LUZERN TË ZVICRËS NË MYFTININË SHKODËR



Ndërsa z. Asani shprehu vlerësim të veçantë për punën e Myftinisë Shkodër dhe për kontributin e saj në përhapjen e vlerave shpirtërore dhe kulturore.

Në shenjë respekti dhe miqësie, përfaqësuesit e të dy institucioneve shkëmbyen dhurata simbolike, duke nënvizuar dëshirën për forcimin dhe thellimin e bashkëpunimit në të ardhmen.

Pas takimit, delegacioni i xhamisë “Drita” i shoqëruar nga imami i xhamisë Barbullush, H. Ervis Molla, vizitoi disa nga xhamitë më të rëndësishme të Shkodrës, përfshirë xhaminë e Parrucës, xhaminë “Ebu Beker”, xhaminë e Plumbit, etj, ku u njohën nga afër me historinë, arkitekturën dhe trashëgiminë islame që karakterizon qytetin e Shkodrës.



MYFTIU I SHKODRËS, I FTUAR I B.I.SH. “EBU HANIFE”, NË GRENCEN TË ZVICRËS

Me ftesë të Kryetarit të Bashkësisë Islame Shqiptare “Ebu Hanife”, në Grenchen të Zvicrës, H. Sunaj Osmani, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, mori pjesë në një cikël aktivitetesh të organizuara gjatë periudhës 4-7/12/2025 në xhaminë “Ebu Hanife”.

Gjatë kësaj vizite në Zvicër, Myftiu i Shkodrës, pati mundësi të takohet me miq e dashamirë të aktivitetit islam në diasporë, imamë e veprimtarë të zellshëm, me të cilët ndau mendime, ide e përvoja të ndërsjellta.

Në program të vizitës së Myftiut të Shkodrës në Grenchen ishin edhe tryeza të ndryshme me grupe të rinjsh, veprimtarësh dhe drejtuesish të Bashkësisë Islame Shqiptare “Ebu Hanife”.

Ligjërata e ditës së xhuma, më 5 dhjetor



2025, ishte shfaqja e dokumentarit “Triumfi i zanit të minareve”, me çrast Myftiu foli edhe rreth lirisë së besimit dhe vlerave të shfrytëzimit të kohës në shërbim të thirrjes islame dhe edukimit të brezit të ri me mësimet, udhëzimin dhe tabanin e baballarëve.

Poashtu, Myftiu Sytari ligjëroi në tribunën fetare të ditës së shtune, më 6 dhjetor 2025, ku iu drejtua të pranishmëve të shumtë në xhaminë “Ebu Hanife” rreth një temë që ndërlihd përkushtimin e

muslimanit për t’u dëshmuar si individ i shëndosh dhe ndërtues i vlerave në shoqëri, mbrojtës i traditave më të mira kombëtare, harmonisë në mesin e besimtarëve dhe njerëzve mbarë pa dallim, ruajtjen dhe promovimin e paqes sociale, kultivimin e dijes, zhvillimit dhe arritjeve në jetë, mbrojtjen e familjes tradicionale, përkushtimin për të dëshmuar në çdo moment të jetës shpirtin e madh të trashëgimisë islame me vepra dhe me këdo prej krijesave të Zotit.

Gjatë qëndrimit të tij disa ditë në mikpritjen e BISH “Ebu Hanife” në Grenchen pati mundësi të shoh edhe mënyrën e organizimit të kësaj bashkësie islame, aktivitetin e larmishëm, tubimet, aktivitetet dhe frymën e harmonisë që dominon në mesin e besimtarëve muslimanë shqiptarë, por jo vetëm, në këtë vend.



MYFTIU I SHKODRËS PRITI KRYETARIN E B.I. “ASR” E.V. INGOLSTADT, H. MIRSA DERVISHI

Ditën e martë, më 9 dhjetor 2025, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari priti në një takim të përziemërt Kryetarin e Bashkësisë Islame “ASR” e.V. Ingolstadt, H. Mirsad Dervishi.

Gjatë takimit të përziemërt, Myftiu i uroi mirëseardhjen në qytetin e Shkodrës mikut të vjetër, H. Mirsad Dervishi me të cilin pati një bashkëbisedim të ngrohtë dhe vëllazëror.

Nga ana e tij, Kryetari i B.I. “ASR” e.V., H. Mirsad Dervishi shprehu kënaqësinë e madhe të kësaj vizite në qytetin e Shkodrës, ku theksoi se Shkodra mbetet një pikë referimi për të gjithë muslimanët shqiptarë, një kryeqendër e zhvillimeve të mëdha islame dhe mbi të gjitha një pikënisje e madhe e rimëkëmbjes fetare në Shqipëri.

Me rastin e kësaj vizite në Shkodër, H.



Mirsad Dervishi në shoqërinë e Myftiut të Shkodrës zhvilloi një takim edhe në xhaminë e Plumbit, ku bashkërisht falën edhe namazin e akshamit.

Gjatë qëndrimit në kompleksin më të ri islam të qytetit të Shkodrës miku i shtrenjtë nga Ingolstadt vlerësoi punën e madhe që është bërë për rimëkëmbjen

e xhamisë së Plumbit dhe kthimin e këtij objekti të shtrenjtë në një vend tërheqës për këdo që viziton Shkodrën dhe Shqipërinë.

Për nder të kësaj vizite, Myftiu shtroi një drekë falënderimi dhe mikpritjeje gjatë së cilës u diskutua për tema me interes të përbashkët.

U ZHVILLUA MBLEDHJA E RADHËS E IMAMËVE TË MYFTINISË SHKODËR

Paraditen e së mërkurës, më 10 dhjetor 2025, u zhvillua mbledhja e radhës e imamëve të Myftinisë Shkodër.

Thelbi i këtij takimi ishte diskutimi mbi disa çështje me rëndësi për shërbimet dhe angazhimet plot përkushtim të imamëve të Myftinisë Shkodër.

Një vëmendje e posaçme iu kushtua qarkores së Komunitetit Mysliman të Shqipërisë për disiplinimin e ceremonive të kurorëzimit, ku sipas udhëzimeve paraprahe u vu theksi te rëndësia që ka ky shërbim për çiftet e reja, si dhe u vlerësua roli i imamit në ndërgjegjësimin e besimtarëve dhe



masës së gjerë për vlerën dhe rëndësinë e kësaj tematike që lidhet me familjen dhe pozitën e saj në fenë islame.

U diskutua edhe për një sërë çështjesh me interes për komunitetin, si dhe u dhanë udhëzimet e duhura për mbarëvajtjen e punës në vazhdim.

“GJUHA ARABE: BESIM, MENDIM DHE QYTETËRIM”, AKTIVITET ME RASTIN E DITËS BOTËRORE TË GJUHËS ARABE

Ditën e enjte paradite, më 18 dhjetor 2025, Myftinia Shkodër organizoi me rastin e 18 dhjetorit, Ditës Botërore të Gjuhës Arabe, në ambientet e bibliotekës së qytetit një aktivitet kulturor dhe edukativ për motrat muslimane, i shoqëruar me promovimin e librit: “Shkenca fton në besim”, të autorit Abraham Cressy Morrison, përkthyer nga arabishtja në gjuhën shqipe nga MSc. Arta Ujkaj.

Aktiviteti kishte për qëllim rritjen e ndërgjegjësimit mbi vlerat historike, kulturore dhe shpirtërore të gjuhës arabe, si dhe prezantimin e librit të përkthyer nga gjuha arabe si një dëshmi e pasurisë së saj të jashtëzakonshme intelektuale.

Në një atmosferë të ngrohtë, me pjesëmarrjen e grave nga fusha të ndryshme si pedagoge, psikologe, mësuese, studente dhe maturante, u theksua roli i gjuhës arabe si gjuhë e



shpalljes hyjnore, dijes dhe qytetërimit botëror.

Programi u hap nga MSc. Zamira Bushati, e cila pasi përshëndeti pjesëmarrëset foli mbi rëndësinë e Ditës Botërore të Gjuhës Arabe, duke mbajtur temën: “Gjuha arabe: besim, mendim dhe qytetërim”. Ajo u ndal në dimensionet gjuhësore, kulturore, intelektuale dhe

shpirtërore të arabishtes.

Më pas, pedagogia e Universitetit të Shkodrës, Dr. Arselida Mashaj, trajtoi tematikën e librit përmes ligjëratisë “Shkenca fton në besim”, duke vënë në pah harmoninë ndërmjet shkencës dhe besimit, veçanërisht në fushën e zbulimeve biologjike.

Në fjalën e saj, përkthyesja e librit, MSc. Arta Ujkaj, solli një pasqyrë reflektuese mbi procesin e përkthimit dhe rëndësinë e përcjelljes së këtij mesazhi në gjuhën shqipe.

Aktiviteti u përmbyll duke shprehur mirënjohje për organizatorët dhe pjesëmarrëset, si dhe me urimin që iniciativa të tilla kulturore të shtohen dhe të vijnë edhe në të ardhmen, ndërsa të pranishmet patën mundësinë të marrin dhuratë një kopje të librit në fjalë.



EKSPOZITA “NGJYRAT E BESIMIT” NË QENDRËN KULTURORE BARBULLUSH

Në ambientet e Qendrës Kulturore, pranë xhamisë Barbullush, Myftinia Shkodër, përmes sektorit të arsimit, organizoi paraditen e së mërkurës, më 24 dhjetor 2025, ekspozitën artistike “Ngjyrat e besimit”, me punime pikturë të realizuara nga nxënësit e kurseve fetare të kësaj qendre.

Aktiviteti u çel me një përshëndetje nga drejtuesi i Arsimit pranë Myftinisë Shkodër, teologu Arben Halluni, i cili falënderoi të gjithë pjesëmarrësit për praninë e tyre, nxënësit për përkushtimin dhe kreativitetin e treguar, mësuesit për udhëheqjen dhe organizimin e vazhdueshëm të kurseve të ndryshme, si dhe prindërit për mbështetjen dhe nxitjen e fëmijëve drejt artit, krijimtarisë dhe aktiviteteve të tilla edukative.



Gjithashtu, ai shprehu mirënjohje për të gjithë ata që mbështesin dhe kontribuojnë në zhvillimin e këtyre aktiviteteve kulturore dhe fetare.

Më pas, një fjalë përshëndetëse mbajti Imami i xhamisë Barbullush,



H. Ervis Molla, i cili falënderoi pjesëmarrësit dhe vlerësoi rëndësinë e kultivimit të artit dhe vlerave shpirtërore të fëmijët, duke i inkurajuar ata të vazhdojnë rrugën e krijimtarisë dhe edukimit të shëndoshë.



Gjatë ekspozitës u shpalosën piktura të shumta me tematikë fetare, kulturore dhe tradicionale, ndërsa piktura më e vlerësuar e ekspozitës nga komisioni ishte ajo e nxënëses Medina Kameri, e cila kishte paraqitur në mënyrë

artistike xhaminë Barbullush, duke e ndërthurur bukur me elemente të Qendrës Kulturore.

Aktiviteti u përmbyll në një atmosferë të ngrohtë bashkëbisedimi, ku të pranishmit patën mundësinë të

shijonin edhe një koktej rasti, duke e kthyer këtë ekspozitë në një moment të veçantë vëllazërimi dhe bashkimi komunitar.

Ekspozita do të qëndrojë e hapur për vizitorët deri më 31 dhjetor 2025.



MYFTIU I SHKODRËS VIZITOI BASHKËSINË ISLAME NË LUGINËN E PRESHEVËS

Ditën e enjte, më 25 dhjetor 2025, me ftesë të Kryetarit të Bashkësisë Islame për Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, H. Nexhmedin ef. Ademi, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, zhvilloi një vizitë dyditore, e para e këtij lloji në Luginën e Preshevës.

Myftiu i Shkodrës zhvilloi një vizitë në ambientet e Bashkësisë Islame për Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, ku u prit nga Kryetari i saj, H. Nexhmedin ef. Ademi me bashkëpunëtorë.

Gjatë takimit të përzemërt, u diskutua për një sërë çështjesh me interes të për bashkësitë, në krye të cilave ishte bashkëpunimi dhe rritja e rrugëve të komunikimit në shërbim të besimtarëve.

Myftiu Sytari ligjëroi edhe në mbrëmjen kur'anore, që u organizua nga BIPBM dhe Forumi Rinor “Rahovica”, në sallën



e madhe të kulturës në Preshevë, që nisi me urimet dhe mesazhet e Kryetarit të Bashkësisë Islame për Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, H. Nexhmedin Ademi, si dhe Kryetarit të Forumit Rinor, H. Leutrim Asllani. Programi vijoi me ligjëratën e Myftiut të Shkodrës, si dhe

mesazhet e urta të studiuesit të afirmuar, Dr. Musa Musai.

Ndërkohë, ditën e xhuma, më 26 dhjetor 2025, Myftiu i Shkodrës iu drejtua besimtarëve të pranishëm në xhaminë qendrore të Preshevës me mesazhe të qarta që kanë të bëjnë



me rritjen e harmonisë, vëllazërisë, solidaritetit dhe mbi të gjitha ruajtjen e identitetit islam dhe kombëtar në rrugëtimet e dëshimit të vlerave islame, edhe si pjesë e trashëgimisë shekullore të paraardhësve tanë.

Poashtu, sekretari organizativ i

Myftinisë Shkodër, H. Lavdrim Hamja ligjëroi në xhaminë e Corroticës, në Komunën e Preshevës, ku iu drejtua besimtarëve me mesazhe të urta në atmosferën e begatë të Tre Muajve të Mirë në prag të muajit të madhërisëm të Ramazanit.

Vizita e parë e Myftiut të Shkodrës në Luginën e Preshevës u prit me nderime dhe respekte të mëdha nga drejtuesit e BILP dhe besimtarët e shumtë, të cilët i uruan atij mirëseardhjen dhe kërkuan që këto vizita të jenë më të shpeshta.



KURSE INTENSIVE DIMËRORE NË QENDRËN KULTURORE PRANË XHAMISË OBLIKË

Në kuadër të ndjekjes nga afër të veprimtarive arsimore dhe fetare, teologu Arben Halluni, drejtues i Arsimit pranë Myftinisë Shkodër, zhvilloi ditën e hënë, më 29 dhjetor 2025, një vizitë pune në Qendrën Kulturore pranë Xhamisë Oblikë, për të inspektuar ecurinë e kurseve dimërore intensive që po zhvillohen gjatë pushimeve dimërore.

Këto kurse, të cilat kanë filluar më 22.12.2025 dhe zgjasin rreth dy javë, nën kujdesin e përkushtuar të mësueses znj. Kimete Elezi po zhvillohen sipas një programi përkatës, ku nxënësit përfitojnë mësim intensiv në leximin e Kur'anit Famëlartë, mësimin e sureve përmendësh, njohuri nga Sira/jeta e Pejgamberit (a.s), si dhe aktivitete edukativo-argëtuese.

Gjatë vizitës, drejtuesi i arsimit u njoh nga afër me zhvillimin e mësim, bisedoi me nxënësit dhe u drejtoi atyre



disa këshilla fetare dhe edukuese, duke i inkurajuar për përkushtimin dhe pjesëmarrjen e rregullt në këto kurse, të cilat frymëzojnë brezin e ri me parimet e besimit, moralit, paqes dhe harmonisë më të gjithë njerëzit.

Një pjesë e rëndësishme e programit të shkollës dimërore kanë qenë edhe

vizitat edukative në xhamitë e Anës së Malit, konkretisht në xhamitë e Shtufit, Muriqanit, Velinaj, Alimetajt dhe Zuesit.

Përmes këtyre vizitave, nxënësit, nën drejtimin e imamëve përkatës, janë njohur me historikun e xhamive, rolin e tyre në komunitet dhe kanë marrë mesazhe të shkurtra fetare e motivuese.



NISMA NDËRKOMBËTARE UNIVERSITARE E TURQISË HYN NË FAZËN E REALIZIMIT: HAPET UNIVERSITETI NDËRKOMBËTAR ISLAM I SHKENCËS DHE I TEKNOLOGJISË NË STAMBOLL

H. LUTFI BALLEK - PRIZREN

Në sheshin historik Sultanahmet, në zemër të Stambollit, Universiteti Ndërkombëtar Islam i Shkencës dhe Teknologjisë i Turqisë (Türkiye Uluslararası İslâm Bilim ve Teknoloji Üniversitesi), i themeluar në vitin 2015, zyrtarisht ka filluar fazën e parë të realizimit të tij. Me këtë është bërë një hap i rëndësishëm drejt ndërtimit institucional të një universiteti që ka për ambicie të bashkojë shkencat islame, disiplinat shoqërore e humane, shkencat bazë dhe teknologjinë brenda një vizioni të vetëm civilizues.

Themelimi i këtij universiteti zhvillohet në një kontekst të ndërlikuar dhe sfidues të botës islame bashkëkohore. Stambolli, gjatë viteve të fundit, është bërë strehë për shumë dijetarë dhe akademikë nga vende të ndryshme të cilët, për shkak të shkatërrimeve të luftës, paqëndrueshmërisë politike dhe rrethanave të tjera të pafavorshme në vendet e tyre, kanë vazhduar veprimtarinë pikërisht në këtë qytet. Universiteti lind nga nevoja për t'i ofruar këtij potenciali të madh intelektual një kornizë institucionale në të cilën dituria, përvoja dhe kapaciteti shkencor do të zhvillohen në mënyrë sistematike. Iniciativës i jep rëndësi shtesë edhe fakti se shumë qendra tradicionale të dijes islame vitet e fundit janë shkatërruar

ose janë dobësuar seriozisht.

Rrektori i Universitetit dhe dijetari i shquar islam, prof. dr. Mehmet Görmez, theksoi se Universiteti Ndërkombëtar Islam i Shkencës dhe Teknologjisë i Turqisë do të ndërtohet si një institucion akademik që e lidh trashëgiminë autentike islame dhe civilizuese me çështjet e kuptimit, vlerave dhe përgjegjësisë së njeriut bashkëkohor. Një vizion i tillë mbështetet edhe në punën e tij shumëvjeçare akademike dhe në kuptimin e tij të filozofisë së shkencave islame dhe shoqërore, të cilat ai i ligjëron dhe zhvillon në Institutin për Mendim Islam në Ankara.

DEKLARATA

E PROF. DR. MEHMET GÖRMEZIT:

“Universiteti Ndërkombëtar Islam i Shkencës dhe Teknologjisë i Turqisë, i themeluar në vitin 2015, së bashku me Fondacionin për Forcimin e Universitetit, sot ka hedhur hapin e parë në fazën e realizimit në sheshin historik të Sultanahmetit, në zemër të Stambollit. Para së gjithash, falënderoj Zotin e Madhëruar, i cili ma ka besuar këtë detyrë si amanet dhe na ka bërë shërbëtorë të rrugës së dijes dhe urtësisë. Falënderoj edhe Presidentin e Republikës, i cili më ka besuar këtë përgjegjësi të rëndë dhe të jashtëzakonshme.

Mbi kujtesën shekullore islame dhe civilizuese të Stambollit, do të përipiqemi

të ndërtojmë Universitetin tonë si një institucion akademik që trashëgiminë tonë autentike civilizuese e lidh me horizontet e kuptimit, vlerave dhe përgjegjësisë së njeriut bashkëkohor. Ky institucion nuk do të kufizohet vetëm në arsimin e lartë teologjik, por do të jetë një model universitar që bashkon shkencat islame, shkencat humane, shkencat bazë dhe teknologjinë brenda të njëjtës vetëdije civilizuese.

Universiteti ynë do të jetë një universitet kërkimor i fuqishëm, i hapur për bashkëpunime shkencore dhe kërkimore ndërkombëtare, me studimet pasuniversitare në qendër të punës së tij. Qëllimi ynë është që, duke mbledhur studentë, akademikë dhe studiues të shquar nga i gjithë bota rreth një gjuhe të përbashkët civilizuese, të mundësojmë që dituria jo vetëm të prodhohet, por edhe të shndërrohet në vlerë të qëndrueshme dhe të mirë të përbashkët për njerëzimin.

Paraprakisht falënderoj të gjithë profesorët, miqtë dhe njerëzit e dijes nga Turqia, bota islame dhe nga të gjitha anët e gjeografisë sonë shpirtërore, të cilët do ta mbështesin këtë hap të madh shkencor. Qoftë për të mirë për popullin tonë, për vendin tonë dhe për traditën e lashtë të dijes në Stamboll. Lus që i Madhi Zot ta bëjë këtë institucion të qëndrueshëm në mirësi dhe ta bekojë përpjekjen dhe angazhimin tonë. Amin.”


(www.gazetaere.com)



DOLI NË QARKULLIM BULETINI VJETOR I MYFTINISË SHKODËR PËR VITIN 2024, NR. 15

Myftinia Shkodër sapo ka nxjerrë në qarkullim Buletin e saj vjetor, nr. 15, një përmbledhje e aktiviteteve të larmishme, vizitave dhe vizitorëve, takimeve dhe veprimtarive të larmishme arsimore të mejtepeve fetare, xhamive, imamëve dhe këshillit të Myftinisë, përgjatë vitit 2024.

Ky botim shërben si një pasqyrë e angazhimit të institucionit të Myftinisë Shkodër në jetën fetare, sociale dhe kulturore të zonës Shkodër.



Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

 
MYFTINIASHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org